



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A.nr.416 / 20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 dhe 9 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “FONDERIA E & E SH.P.K. Gjakovë, të parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi i ulëseve për parqe , kontejner te vegjël për mbeturina, kapak te pesetave dhe ujëmbledhës” me nr prokurimi AP :632-20-1148-121, te iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 13.07.2020 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “FONDERIA E & E SH.P.K. Gjakovë , me nr. të protokolli. 416/20, e datës: 25 QERSHOR 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe montimi i ulëseve për parqe , kontejner te vegjël për mbeturina, kapak te pesetave dhe ujëmbledhës” me nr prokurimi AP :632-20-1148-121, te iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës.

- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Komuna e Gjakovës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe montimi i ulëseve për parqe , kontejner te vegjël për mbeturina, kapak te pesetave dhe ujëmbledhës” me nr. prokurimi AP :632-20-1148-121, përkitazi me këtë ankesë (nëse nuk ka ankesë tjetër).
- III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A, të LPP-së, nenit 4 dhe nenit 9.1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave , operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës konform nenit 31 pika 4 te Rregullores të Punës së OSHP-së.
- IV. **Obligohen**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 te Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 25 QERSHOR 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “FONDERIA E & E SH.P.K. Gjakovë , me nr. të protokolli. 416/20, kundër njoftimit për dhënie te kontratës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “FONDERIA E & E SH.P.K. Gjakovë me nr. te protokollit 416/20, te dt. 25.06.2020, dhe sheh se ankesa në fjalë është parashtruar në kundërshtim me nenin 108/A te LPP-së , nenin 4 dhe 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave .

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi i ulëseve për parqe , kontejnerëve te vegjël për mbeturina, kapak te pesetave dhe ujëmbledhës” me nr. prokurimi AP :632-20-1148-121, te iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës, AK i ka njoftuar me vendimin e tyre OE-të me dt. 21.05.2020.

Kundër këtij vendimi te AK-së OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt. 25.05.2020.

Me dt. 01.06.2020, AK aprovon kërkesën e OE ankues dhe aktivitetin e prokurimit në fjalë e kthen në Rivlerësim.

Pas Rivlerësimit me dt. 24.06.2020 AK i njofton serish operatorët ekonomik me anë te letrës standarde për tenderuesit e eliminuar, te pa suksesshëm dhe vendimin e AK-së njoftimin për dhënie te kontratës .

Kundër njoftimeve te cekura si me lart të 24.06.2020, OE ankues nuk inicion procedurën për ankesë në autoritetin kontraktues ashtu siç parashihet me nenin 108/ A LPP-së dhe nenin 4 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave në AK , por ankesën e drejton në OSHP.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e dhëna si me lart Organi Shqyrtues i Prokurimit(OSHP) konstaton se ankesa e OE “FONDERIA E & E SH.P.K. Gjakovë me numër te protokollit 416/2020 e dt. 25.06.2020, nuk mund te shqyrtohet nga OSHP për faktin se OE ankues nuk ka udhëhequr një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në shkallen e pare te ankimimit në AK dhe te merrte një përgjigje nga AK , dhe vetëm pas marrjes se kësaj përgjigje konform afateve ligjore ti drejtohej OSHP-së për ankese lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit vjen në përfundim se ankesa me numër 416/2020 e dt. 25.06.2020,e parashtruar nga OE “FONDERIA E & E SH.P.K. Gjakovë, hedhet si e pa lejuar nga fakti se ankuesi ne pajtim me nenin 108/A te LPP-së dhe nenit 4 te Rregullat e paraqitjes

së kërkesës për rishqyrtim pran autoritetit kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, menjëherë pas Njoftimit me ane te letrës standarde për tenderuesin e eliminuar apo te pa suksesesh, pas rivlerësimit është dashur ti drejtohet prap AK-së me ane te kërkesës për rishqyrtim dhe vetëm pas marrjes se përgjigjes nga AK lidhur me kërkesën e tyre për rishqyrtim ti drejtohet OSHP-së me anë te ankesës .

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komuna e Gjakovës

1x1 OE “FONDERIA E & E SH.P.K. Gjakovë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

